



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 29 prill 2015, në mbledhjen e XVI-të
(gjashtëmbëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalju, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, Nazmi Elezi, Shef i Zyrës së Informimit dhe Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE – së.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe:

- Propozimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve e perimeve në fshatin Sfeçël, Komuna e Podujevës.

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri së bashku me pikën plotësuese të propozuar nga kryesuesi.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 30 mars 2015

z. Naim Çunaku, theksoi, në diskutimin tim në faqen e dytë të Ekstraktit të procesverbalit ku thuhet “ e kjo është në kundërshtim me Rregulloren “ duhet të korrigohet “ këtë materie e rregullon Rregullorja”

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri me korrigjimin e paraqitur nga parafolësi.

3. Raporti financiar për periudhën janar – mars 2015

z. Rafet Llapashtica, theksoi, të hyrat vetanake në shumë 25.924 € nuk janë të specifikuara prej cilave burime janë arkëtuar, andaj kjo do duhej të sqarohet.

Te shpenzimet sipas kodeve përshtypje më kanë bërë shpenzimet për udhëtime brenda vendit në shumë 4.071 € që sipas mendimit tim janë shpenzime të mëdha dhe të pajustificueshme, ashtu siç janë edhe furnizimet për zyrë për periudhën tremujore afër 20.000 €, shpenzime për të cilat duhet dhënë sqarime

Pagesa e bërë sipas nenit 32.9 të LMFPP në shumë prej 7.633 € është pagesë e dhunshme ngase komuna nuk i ka shlyer me kohë obligimet për punët e kryera.

Si problem në këtë raport tremujor por edhe në raportin e vitit 2014 është se askund nuk janë specifikuar të hyrat, pa bazë ligjore, për aplikimet lidhur me legalizimin e objekteve në shumë 3 € dhe shtrohet pyetja ku janë ato mjete, kur dihet se kanë qenë afro 4000 aplikime.

Bazuar në këto çështje por edhe në të tjera që nuk i përmenda, konsideroj se ky raport ka mangësi dhe defekte, përfundoi ky diskutues.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket pagesës së taksës në shumë prej 3 € për legalizim të ndërtimeve pa leje kjo është bërë mbi bazën e Rregullores përkatëse, mirëpo me një udhëzues të nivelit qendror nuk është paraparë kjo taksë dhe për këtë Kryetari i Komunës ka vendosur që të gjithë parashtruesve të kërkesave kur e bëjnë pagesën për legalizim do t'ju zbritet shuma e cekur.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket taksës prej 3 €, e përmendi edhe kryesuesi por e ka përmendur edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave se taksa e cekur është paguar në bazë rregullore përkatëse, mirëpo sa unë jam në dijeni në Kuvendin e Komunës nuk është miratuar një rregullore e tillë për marrjen e taksës prej 3 €, pra vendimi është individual qoftë i Kryetarit të Komunës qoftë i drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ngase është në kundërshtim me Ligjin për legalizimin e objekteve të ndërtuar pa leje.

Sa i përket asaj që kryesuesi tha se do të kthehet shuma e taksës së paguar prej 3 €, konsideroj se askush nuk mund të garantoj se të gjithë aplikuesit do të pajisen me leje ndërtimore ngase nuk mund të paragjykojmë se të gjithë i plotësojnë kushtet e parapara ligjore.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, në raport janë paraqitur të gjitha të hyrat dhe të dalat sipas kodeve ekonomike për periudhën tremujore të vitit 2015, janë bërë krahasimet me periudhën përkatëse të vitit paraprak.

z. Haki Rudari, theksoi, për ne Grupin e këshilltarëve të LVV-së është e paarsyeshme që buxheti i paraparë për investime kapitale në shumë më tepër se 5 milion në periudhën tremujore të shpenzohet vetëm 80.764 €, kjo tregon se menaxhimi nuk është i mirë apo kemi mungesë të projekteve kur dihet se jemi një komunë ku ka nevojë për investime të ndryshme, mirëpo duke u bazuar se është tremujori i parë mbetëm me shpresë se në muajt në vazhdim do të rriten investimet.

Krahasuar me vitin paraprak te të hyrat vetanake kemi një ngecje ngase në këtë tremujor arkëtimi i të hyrave vetanake është 6% më i vogël, andaj kjo çështje duhet të analizohet dhe të gjenden arsyet e kësaj ngecjeje.

Te mirëmbajtja e shkollave është evidentuar vetëm shuma prej 8.872 € mirëpo nuk specifikohet se në cilat shkolla janë bërë këto shpenzime.

Në këtë periudhë tremujore nuk është bërë asnjë investim për ndërtimin e trotuareve kur dihet se kemi nevojë emergjente për ndërtimin e trotuareve në veçanti te shkollat të cilat janë buzë rrugëve magjistrale, andaj konsideroj se Drejtoria përkatëse këtë çështje duhet ta merr më seriozisht.

z. Naim Çunaku, theksoi, fillimisht dëshiroj të them se kemi filluar një praktikë të mirë ngase po përgatiten dhe po dërgohen për shqyrtim raportet financiare tremujore që kjo në të kaluarën nuk ka ndodhë e kjo na bënë që ne këshilltarët e Kuvendit përkatësisht anëtarët e Kuvendit Komitetit për Politikë dhe Financa të jemi të jemi në rrjedha të dinamikës të realizimit të projekteve prioritare.

Mbi bazën e krahasimeve me të dhënat e vitit të kaluar vërehet se në këtë periudhë kemi dallime e sipas mendimit tim në disa kode ose është shpenzuar shumë vitin e kaluar ose në këtë vit është lënë mangësi diç.

Duke e pasë parasysh se po debatojmë për tremujorin e parë dhe atë se në këtë periudhë projektet kapitale nuk mund të jenë në vazhden e realizimit në vëllimin që të paktën ne kishim dëshiruar.

E kam përmendur disa herë dhe po e përsëris se, sipas mendimit tim, defektin më të madh përse kemi realizime përkatësisht shpenzime në këtë formë është se ne Komiteti për Politikë dhe Financa e kemi obligim ligjor që të shqyrtojmë Planin vjetor të punës të Zyrës së prokurimit, andaj kjo është vërejtje përse nuk është dërguar edhe materiali i cekur për shqyrtim.

Këshilltari z. Rafet Llapashtica e ngriti çështjen e taksës prej 3 € pagesës të cilën aplikuesit e kanë paguar inicimin e procedurës për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, lidhur me këtë në një mbledhje të kaluar e kam ngritur këtë çështje dhe Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ma ka dhënë një përgjigje në të cilën thirret në Rregulloren përkatëse për taksa dhe ngarkesa, komunale e për pagesën e cekur thuhet se në fazat e mëvonshme do të hulumtohet forma më e mirë që t'ju kompensohet parashtruesve të kërkesave.

z. Abaz Llughaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, është e vërtetë se nga niveli qendror është paraparë që aplikimi për legalizim të jetë pa pagesë, mirëpo duhet të kemi parasysh se çdo parashtrues i kërkesës për legalizim fillimisht e ka identifikuar dhe verifikuar në Kadastër parcelën në të cilën e ka të ndërtuar objektin pa leje ndërtimore e sipas Tarifores përkatëse për identifikimin e parcelës në zyrë parashihet të paguhet taksa prej 5 eurove, për këtë çështje në periudhën e cekur kanë punuar tri zyre në vijimësi dhe asnjë palë nuk ka bërë pagesë edhe pse nga Niveli qendror ky shërbim, në çështjen e legalizimit, nuk ka qenë i liru nga pagesa e taksës së cekur.

z. Naim Çunaku, theksoi, jemi në dijeni se për të gjitha shërbimet të cilat ofrohen në Komunë është Rregullorja e miratuar në të cilën janë të përcaktuara tarifat për shërbimet përkatëse si dhe shërbimet të cilat janë të liruara për kategori të caktuara, mirëpo në rastin e aplikimit për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, pa dyshim është dashtë që të mos merret për bazë rregullorja e cekur ngase ka qenë aksion i Nivelit qendror.

z. Fidan Rekalii, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së e vlerëson dhe e përshëndetë punën dhe angazhimin e drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe

Financave, dhe konsideron se është një raport i mirë, i qartë, i detajizuar dhe i mbështetur në dispozita ligjore.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në diskutimin e mëparshëm i bëra disa pyetje konkrete por nuk mora përgjigje, e ato janë së pari cila rregullore është marrë për bazë lidhur me pagesën e taksës prej 3 € për aplikim për legalizim dhe përse nuk specifikohet në raport se ku janë mjetet e arkëtuara.

Drejtori i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë tha se për identifikimin e parcelave nuk është paguar taksa prej 5 €, lidhur me këtë konsideroj se pala mund të lirohet nga pagesa e taksës për ndonjë shërbim edhe nëse kushton 50 €, por palës nuk mund t'i merren as 10 cent pa bazë ligjore.

Ne kemi kërkuar listën e paluajtshmërive në pronësi të Komunës të dhëna në shfrytëzim, përkatësisht cilat prona janë dhënë me vendime të Kuvendit e cilat jo, mirëpo ky dokument nuk na është dorëzuar.

Në raport thuhet se të hyra të tjera janë 24.000 € por nuk sqarohet se prej nga janë këto të hyra.

Së fundi është çështja e shpenzimeve të zyrtarëve për mëditje brenda vendit në shumë 4000 €, e thash më parë se është shumë mjaft e lartë dhe e paarsyeshme.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, në raport janë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet që kanë ndodhë në periudhën përkatëse. U përmend taksa prej 3 € për aplikim lidhur me legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, unë nuk jam në dijeni për ndonjë dokument i cili e ndalon pagesën e taksës së cekur, pra ne nuk e kemi një vendim të tillë andaj është zbatuar Rregullorja komunale, ndërsa të hyrat nga kjo taksë janë në shumën totale të taksave komunale.

Sa i përket shpenzimeve për mirëmbajtjen e shkollave, këtu përfshihen të gjitha shkollat e kjo ka të bëjë me mirëmbajtjen e përditshme të tyre e që kryesisht janë shërbime higjienike.

U përmenden shpenzimet për udhëtime brenda vendit, në këtë rast është gabim teknik dhe duhet të jetë “ Mëditjet jashtë vendit “.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket çështjes të cilën e ngriti z. Naim Çunaku, lidhur me Planin vjetor të punës të Zyrës së Prokurimit, mund të them se plani i cekur është obligim ligjor dhe i njëjti dërgohet në KRPP, por edhe Auditorët e Jashtëm së pari e kërkojnë atë plan, pra plani i cekur ekziston.

z. Naim Çunaku, theksoi, në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në mënyrë decitive thuhet se një prej kompetencave të Komitetit për Politikë dhe Financa është shqyrtimi i Planit vjetor të punës të Zyrës së Prokurimit, pra shtrohet pyetja përse i njëjti nuk dërgohet për shqyrtim në këtë Komitet.

Në propozim të Kryesuesit, Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me korrigjim të gabimit teknik ku thuhet “Mëditje brenda vendit” të korrigjohet “ Mëditje jashtë vendit”, si dhe:

- *Të ndërmerren masat dhe aktivitetet përkatëse për shtimin e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave vetanake, dhe*
- *Drejtorët e Drejtorive përkatëse, në aspektin e investimeve kapitale të iniciojnë me kohë procedurat e prokurimit në mënyrë që dinamika e realizimit*

të projekteve prioritare dhe shpenzimeve të bëhet sipas dinamikës së planifikuar.

4. Miratimi i propozim Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2015 – 2018.

➤ Raporti për zbatimin e diskutimit publik.

z. Nazmi Elezi, shef i Zyrës së Informimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Naim Çunaku, theksoi, një prej elementeve të Strategjisë i kemi format se si do të bëhet njoftimi i qytetarëve për punën në Komunën tonë. U përmend se në mese të caktuara do të bëhen tabela të shpalljes por këtë materie ne i kemi të miratuara në Kuvend dy rregullore dhe atë Rregulloren mbi transparencën e institucioneve komunale dhe Rregulloren për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. U përmend se këtë çështje e kemi pasë të mbuluar me dy rregullore, mirëpo nëse ndalemi në raport me qytetarët, a e pyesim veten si e ka Komuna e jonë çështjen e organizimit nënkomunal, e këtë nuk e kemi fare të rregulluar e kjo është parakusht që Strategjia përkatëse të jetë e suksesshme përkatësisht në mënyrë që të përcaktohen mekanizmat ku do të bëhen informacionet e ndërsjella, pra kjo ne na mungon.

Jemi në dijeni se prej viti 2008 ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ me të cilin komunat janë të obliguara të miratojnë Rregulloren për bashkëpunim me fshatrat dhe lagjet urbane, mirëpo ne edhe sot e kësaj dite nuk e kemi rregulloren e cekur e cila do të ishte ndihmesë për zbatimin e Strategjisë për të cilën jemi duke debatuar.

Për shefin e Zyrës së Informimit e kam një pyetje e ajo është, a është i kompletuar stafi dhe a kemi kuadro për mbajtjen e ueb faqes zyrtare, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore dhe dispozita nënligjore ?.

z. Haki Rudari, theksoi, informimi dhe komunikimi është pjesë e pandashme e shoqërisë dhe jam i mendimit se përmes informimit dhe komunikimit krijohet një urë lidhëse në mes të qytetarëve dhe institucioneve të Komunës.

Në debatin me qytetarë ka pasë pak pjesëmarrës, mirëpo unë jam i informuar se vërejtjet e qytetarëve janë për mungesën e tabelës së informimit, çështje e cila është përfshirë në raport dhe është shtruar nevoja që tabelat informuese të jenë në mjedise të caktuara.

Çështje me rëndësi është edhe informimi për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, lidhur me këtë jam i mendimit se në këtë drejtim duhet të përfshihen edhe aktivitetet e Grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të Kuvendit të Komunës.

z. Nazmi Elezi, theksoi, Zyra e Informimit i ka dy zyrtarë, mirëpo është publikuar konkursi edhe për një zyrtar e me këtë kjo Zyrë do të kompletohet.

Në ueb faqen zyrtare pjesa e informacioneve bëhet nga Zyra e Informimit, ndërsa pjesa tjetër teknike e rregulloreve, vendimeve të ndryshme, konkurseve, shpalljeve etj. bëhet nga Zyra e Teknologjisë Informative.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me plotësim të çështjeve të përfshira në raport.

5. Propozimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve e perimeve në fshatin Sfeçël, Komuna e Podujevës.

z. Abaz Abazi, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, e paraqiti fjalën hyrëse.

Propozimi i këtij vendimi, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.10'

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-44976
Podujevë,
29 prill 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**